



Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3.7.2003, dhe të nenit 16, par. 1, shkronja **b** dhe neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2008, merr

**V E N D I M**  
**PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES**  
**“QENDRA” NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Qendra” në Prishtinë.

**Neni 2**

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi,

**Neni 3**

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar “Qendra”, e cila përkufizohet: në anën veriore me rrugën “Fehmi Agani” dhe me rrugën “Tringë Ismajli”, në anën lindore tangon unazën “Qendra”, në anën jugore me rr. “Garibaldi”, deri në unazën “Qendra” dhe në anën perëndimore me rr. “Luan Haradinaj”, e cila përfshin një sipërfaqe prej 20 ha.

Lagjes “Qendra” do t’i bashkëngjitet edhe blloku 17 dhe 17a i lagjes, si dhe objekti i Teatrit, e që janë të përfshira në Planin rregullues “Qendra 1”.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës në par. 1 të këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Bartës i detyrave programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit.

Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që të sigurojnë dhe dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, për të cilat konsiderohet se janë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

#### **Neni 5**

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 6**

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i Planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat e qytetarëve për zhvillim të punimeve do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësinë e inkorporimit të lokacionit përkatës në Planin rregullues të këtij kompleksi.

#### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Keshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 8**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01 Nr. 35-1010, më 16.7.2008**

**KRYETARI I KOMUNES**  
**Prof. dr. Isa Musatafa**